



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORE
DREJTORIA I INFRASTRUKTURËS DHE INVESTIMEVE PUBLIKE

Nr. 20661 prot

Vlorë 12.12 2025

PROJEKT VENDIM
Nr. _____ datë _____ 2025

**“Mbi përcaktimin e vendqëndrimeve të mjeteve të transportit rrethqytetës,
interurban dhe ndërkombëtar në qytetin e Vlorës “**

Këshilli i bashkisë i mbledhur sot më datën _____ 2025 mbështetur në Ligjin Nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, kreu VII, neni 23, pika 6, Ligji Nr.8308 datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, të ndryshuar kreu II.1, neni 22, Ligji nr.8378 datë 22.07.1998 “Kodi rrugor i RSH”, neni 7, pika 1f, si dhe pasi shqyrtoi materialin e pregatitur nga Drejtoria e Infrastruktures dhe Investimeve Publike:

V E N D O S I :

I- Të miratojë vendqëndrimet për linjat rrethqytetase, që lidhin Bahkinë Vlorë me Njësitë Administrative (fshatrat) dhe anasjelltas:

- 1- Për zonën e Myzeqesë – Novoselë, Poro, Akërni, Trevllazër , Dëllënjë, Aliban etj.
- 2- Për mjetet e linjave Babicë, Llakatund, Nartë, Zvërnec
- 3- Për mjetet e linjave të Bashkisë Selenicë, Njësi Administrative Kotë, Vllahinë, Sevaster, Brataj, Njësia Administrative Hor Vranisht,

Vendparkimi i mjeteve do të jetë tek sheshi para Supermaket “Haso” dhe te trekëndëshi në hyrje të qytetit në rrugën “Rakip Malile”, 13(trembëshjetë) vendqëndrime paralel me rrugën.

4-Për zonën e Bregut - Orikum, Dukat , Tragjas, vendparkimi i mjeteve të jetë në rrugën “Kosova”, përballë me Universitetin “Ismail Qemali”, 2(dy) vendqëndrime paralel me rrugën.

II- Të miratojë vendqëndrimet për linjat interurban dhe ndërkombëtare :

1-Vendqëndrimi i autobuzave të linjave interurban dhe ndërkombëtar do të jetë në rrugën lidhëse Kastrati – fillimi i Autostradës Vlorë- Fier 12 (dymbëdhjetë) vendqëndrime paralel me rrugën.

IV- Për të gjitha linjat tranzit, intinerari i lëvizjes është:

1- Autostrada Fier – Vlorë – Rrotonto - By-pass dhe anasjelltas.

V- Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Infrastrukturës dhe Investimeve Publike, Policia Bashkiake dhe Ndërmarrja e Shërbimeve Publike. Një kopje për bashkëpunim i dërgohet Policisë së Qarkullimit Rrugor Vlorë.

VI- Vendimi i Këshillit Bashkisë Nr.35 datë 28.04.2022, shfyqizohet.

VII- Ky vendim hyn në fuqi sipas Ligjit Nr. 139/2015 datë 17.12.2015, i ndryshuar, neni 55, pika 6.

KRYETAR

Brunilda Mersini





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
DREJTORIA I INFRASTRUKTURËS DHE INVESTIMEVE PUBLIKE

Nr. 20661 prot.

Vlorë 12.12 2025

R E L A C I O N

“Mbi miratimin e vendqëndrimeve të mjeteve të transportit rrethqytetës, interurban dhe ndërkombëtar në qytetin e Vlorës “

Mbështetur në Ligjit Nr.8308 datë 18.3.1998 “Për transportet rrugore”, të ndryshuar kreu II.4, neni 22,--- “ vendet e nisjes dhe mbritjes së autobuzave përcaktohen me VKB”, Ligjit 8378 datë 22.07.1998”Kodi rrugor i RSH”, neni 7, pika1f , ----“ këshilli bashkiak i vetëqeverisjes vendore përcakton zona të destinuara për parkim, në të cilat qëndrimi i mjeteve kushtëzohet nga pagesa e një tarife që përcaktohet me Vendim të Këshillit Bashkiak”, si dhe në problematikat në parkimet e mjeteve, trafikun e rënduar në qytet dhe qarkullimin e mjeteve në rrugët e qytetit, paraqesim në Këshillin Bashkiak projekt vendimin për sistemimin e vendqëndrimeve të mjeteve që kryejnë transport rrethqytetas, interurban dhe ndërkombëtar.

Më datën 02.12.2025 në Bashkinë Vlorë u zhvillua takimi me përfaqësues të Drejtorisë Vendore të Policisë Vlorë, ku u diskutuan problemet e trafikut në qytet, përmirësimin e lëvizshmërisë së mjeteve, këmbësorëve, për të rritur ndjeshëm elementët e sigurisë rrugore.

Më datë 04.12.2025, u ngrit një grup pune i përbashkët me ekspertë të Policisë Rrugore dhe përfaqësues të Bashkisë Vlorë, i cili ka bërë inspektimin në rrugët e qytetit me ekspertë të trafikut rrugor.

Konkluzionet e këtij inspektimi janë paraqitur nga Drejtoria Vendore e Policisë Vlorë me shkresën Nr. 20633prot. Datë 12.12.2025.

Më datë 05.12.2025 në Sallën e Pallatit të Kulturës Kryetarja e Bashkisë Vlorë zhvilloi dëgjese publike me të gjithë përfaqësuesit që kryejnë transport udhëtarësh me taksì, rrethqytetas, qytetas, interurban dhe ndërkombëtar, me të cilët u diskutuan të gjitha problematikat lidhur me trafikun , sigurinë rrugore, vendqëndrimin e mjeteve të transportit të udhëtarëve.

- Diskutimet u bënë për:

a- sigurinë e këmbësorëve në rrugë kryesore, kryqëzime ku u propozua për semaforët inteligjentë si ne rrugën “Ali Demi”, Rruga “Gjergj Kastrioti”, rrethrotullimi në Skelë , të kryqëzimi te shkolla e naftës dhe rruga nga Narta për Zvernec te kryqezimi.

b- senset e lëvizjes së makinave, krahët e parkimeve, sinjalistikë përparësi të mjeteve.

c- zhvendosja e mjeteve të transportit të udhëtarëve rrethqytetas , të cilët janë propozuar për te trekendëshi në hyrje të qytetit dhe sheshi para Supermarket “Haso” 13 (trembëdhjetë) vendqëndrime autobuza, për zonën e Myzeqesë, Babicë, Llakatund, Nartë, Zvërnec , fshatrat e Lumit të Vlorës , Bashkia Selenice dhe Njësitë Administrative.

d- mjetet e zonës së bregut Orikum- Dukat- Tragjas 2(dy) vendqëndrime te rruga Kosova, përball Universitetit.

e-Për autobuzat e transportit të udhëtarëve interurban dhe ndërkombëtar 12 (dymbëshjetë) vendqëndrime në rrugën nga Kastrati- Fillimi i Autostradës Vlorë- Fier.

f-kufizimi i lëvizjes së mjeteve me fasha orare për furnizimin e bizneseve

k- krijimi i një korsie emergjence funksionale për emergjencat drejt Spitalit të Vlorës.

Bashkëngjitur është shkresa Nr.10050prot. datë 12.12.2025, bërë hyrje në bashki me Nr.20633 prot. Datë 12.12.2025, e Drejtorisë Vendore të Policisë “Propozimet për sinjalistikën rrugore në zonën urbane të qytetit të Vlorës”.

Drejtoria e Infrastrukturës dhe Investimeve Publike në mbështetje të diskutimeve dhe propozimeve me përfaqësues të Policisë Rrugore dhe ekspertëve të trafikut rrugor, paraqet këtë projekt vendim për zhvendosjen e vendqëndrimeve të mjeteve të transportit të udhëtarëve rrethqytetës, interurban dhe ndërkombëtar.


- Oraret e qëndrimit të autobuzave në këto vëndparkime janë sipas orareve në licenca.

- Në këto vëndparkime do të qëndrojnë vetëm mjete që kanë oraret e nisjes, duke qëndruar gjysëm ore para nisjes. Të gjithë mjetet që nuk kanë orarin e nisjes do të qëndrojnë në vëndparkime të tjera.


Me këtë sistemim të vëndparkimeve synojmë të arrijmë lehtësimin edhe të ngarkesës brenda qytetit ,duke patur në qëndër të vëmendjes lehtësimin e trafikut brenda qytetit dhe sigurinë rrugore të qytetarëve.

Mendojme se ky është një sistemim i përshtatshëm i vëndparkimeve për ti shërbyer sa më mirë komunitetit.

Duke u nisur nga sa me sipër kërkojmë nga Këshilli Bashkisë, që të bëhet miratimi i këtij projektvendimi, për të pasur një shërbim transporti udhëtarësh në cilësi sa më të mirë.


KRYETAR,
Brunilda Mersini

PARKIMET RRETHQYTETËSE
13 VENDPARKIME




PARKIME RRETHQYTETËSE
12 VENDPARKIME

Google Earth



2 VENDPARKIME

Google Earth



20633

12.12.2025



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHTETIT
DREJTORIA VENDORE E POLICISË VLORË

Nr. 1050 Prot.

Vlorë, më 12.12.2025

Lënda: Propozime për sinjalistikën rrugore në zonën urbane të qytetit të Vlorës.

Drejtuar:**BASHKISË VLORË**

Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Infrastrukturës
Adresa: Lgj. "Karabash", rruga "Zigur Lelo"

VLORË

Në kuadër të bashkëpunimit institucional ndërmjet **Bashkisë Vlorë** dhe **Drejtorisë Vendore të Policisë Vlorë**, si dhe pas inspektimeve të detajuara të kryera në disa akse kryesore dhe dytësore të qytetit, janë identifikuar një sërë problematikash të rëndësishme që lidhen me qarkullimin rrugor, sigurinë e përdoruesve të rrugës dhe menaxhimin e trafikut urban.

Bazuar në vlerësimet e kryera në terren dhe analizën e situatës aktuale, paraqiten më poshtë propozime teknike të cilat synojnë:

- **Përmirësimin e sinjalistikës horizontale dhe vertikale.**
- **Rritjen e sigurisë rrugore për përdoruesit rrugore.**
- **Organizimin më efikas të trafikut rrugor, me qëllim rritjen e kapacitetit të qarkullimit.**
- **Optimizimin i qarkullimit rrugor në segmente të rëndësishme të qytetit të Vlorës;**
- **Krijimin e një infrastrukture funksionale, të standardizuar dhe të harmonizuar me kërkesat bashkëkohore të qarkullimit të mjeteve në zonën urbane.**

Këto masa janë të domosdoshme për të reduktuar ngjarjet rrugore, përmirësuar lëvizshmërinë e mjeteve, këmbësorëve dhe për të rritur ndjeshëm elementët e sigurisë rrugore.

Përbërja e grupit të punës

Më datë **04.12.2025**, me urdhër të Drejtorit të Policisë Vlorë, u ngrit një grup pune i përbashkët i përbërë nga ekspertë të **Policisë Rrugore** dhe përfaqësues të **Bashkisë Vlorë**, konkretisht nga Drejtoria e Urbanistikës, si më poshtë :

1. Shefi i Sektorit të Policisë Rrugore në Drejtorinë e Përgjithshme – Kryekomisar
Ledian Kerka

pas inspektimeve në zonën urbane

inspektimeve të kryera në zonën urbane, ku u evidentua një fluks i lartë trafiku dhe problematika të theksuara që lidhen me sigurinë rrugore, lëvizshmërinë e rrjedhshme të përdoruesve të rrugës dhe mangësitë në sinjalistikën rrugore, grupi i punës propozon kryerjen e ndërhyrjeve dhe rregullimeve si më poshtë:

1. Krijimi i një korsie funksionale për emergjencat drejt Spitalit të Vlorës

Është konstatuar se segmenti rrugor nga “Kapelja” deri te Spitali i Vlorës nuk siguron një korsie të dedikuar për autoambulancat, pasi korsia aktuale anësore shpesh bllokohet nga parkimi informal, duke shkaktuar vonesa kritike në oraret e pikut. Për këtë arsye rekomandohen masat e mëposhtme:

- Heqja e korsisë aktuale të emergjencës në krahun e djathtë, nga Bashkia deri në hyrje të Spitalit.
- Krijimi i një korsie në mes të aksit rrugorë për emergjencat dhe sigurinë e lëvizjes, e shënuar me sinjalistikë horizontale përmes dy vijave të pandërprera ngjyrë të verdhë, me distancë 1.9–2 m nga njëra-tjetra.
- Aplikimi i vijës së verdhë qendrore me shënimin “KORSI EMERGJENCASH” çdo 15 metra, shoqëruar me shigjeta devijuese të trafikut. (sinjalistikë horizontale)
- Vendosja e sinjalistikës vertikale “Korsi e dedikuar për emergjencat” dhe “Ndalim parkimi, pushimi dhe sinjalizim plotësues zhvendosje me karotrec”, .

2. Zhvendosja e mjeteve të transportit publik

- Mjetet e transportit kombëtar dhe ndërkombëtar të zhvendosen në segmentin urban kryesor **Rrethrrrotullimi i Nartës – Rrethrrrotullimi Kastratit**, në të dyja krahët e karrexhatës, në hapësirat tashmë të përcaktuara nga Bashkia e Vlorës.
- Për qytetarët që do të lëvizin drejt qytetit, sugjerohet që linja e transportit urban ekzistuese të zgjaten deri në Rrethrrrotullimin e Nartës.
- Linjat ndërqytetase që operojnë në zonat rurale (fshatrat), të vendosen pranë ish-fabrikës së tullave dhe të mos futen në qendrën e qytetit të Vlorës.

3. Kufizimi i lëvizjes së mjeteve

- Për mjetet e transportit të përzier (ATP) të vendoset fashë orari për furnizim dhe qarkullim brenda qytetit, me përjashtim të rrugës Transballkanike dhe zonës Triport.
- Për mjetet që transportojnë mbeturinat e qytetit të Vlorës dhe pastrimin e tij, të caktohet një fashë orari ku lëvizjet e mjeteve janë të rralla.

4. Masa për rritjen e sigurisë rrugore

Segmenti nga rrethrrrotullimi i Nartës deri në rrethrrrotullimin e Skelës, i cili klasifikohet si një nga akset më të ngarkuara të qytetit të Vlorës, paraqet një numër të konsiderueshëm degëzimesh, prani të bizneseve dhe kalime të shpeshta të këmbësorëve. Si rrjedhojë, janë evidentuar raste të shpeshta ngjarjesh rrugore mjet-këmbësor. Për rritjen e sigurisë rrugore rekomandohen masat e mëposhtme:

met e këmbësorëve të vendosen **jo më afër se 100 metra** nga njëri-tjetri, në rrethje me nenin 188/2 të Kodit Rrugor, dhe të pajisen me sinjalistikën e nevojshme horizontale dhe vertikale, si dhe me ndriçues flesh.

Vendosja e një **semafori inteligjent me buton** të përdorshëm nga këmbësorët në segmentin midis dy rrethrotullimeve.

- Instalimi i **shtyllave sinjalistike me panele reflektuese**, ndriçim LED dhe ndriçim direkt mbi vijat e bardha për rritjen e dukshmërisë së këmbësorëve gjatë natës.
- Vendosja e ngadalsuesve të shpejtësisë pran vendkalimit të këmbësorve ndryshe të quajtur ‘Policëte shtrirë’.
- Rifreskim i vijëzimeve në vende të caktuara për kalimin e këmbësorve, pasi janë të fshira.
- Vendosja e shtyllave elektrike ndriçuese, pasi nga analizimi i rrethanave të ndodhjes së aksidenteve rrugore, janë përfshirë në kushte erresire orare 18:00-23:00, gjithashtu për rritjen e sigurisë së këmbësorëve në kryqëzimet me rrezikshmëri të lartë, rekomandohet instalimi i sinjalistikës ndriçuese/flesh dhe semaforëve inteligjentë me buton në këto pika:
- Kryqëzimi i Rrugës Sazani me Rrugën e Nartës (Triport)
- Kryqëzimi “Ura e Degës”
- Kryqëzimi pranë “Mobileri Aliko”
- Rrethrotullimi i Skelës (në të katërta degëzimet)

6. Masa për rregullimin e trafikut dhe parkimit në qytet

- Vendosja e sinjalistikës vertikale për mos lejin e qëndrimit të mjeteve në të dyja anët e rrugës pranë shkollës 9-vjeçare “Ismail Qemali”.
- Vendosja e sinjalistikës së përparësisë në kryqëzimin e Aleksandrisë për mjetet që lëvizin në Bulevard.
- Rregullimi i sinjalistikës në trekëndshin pranë Sigurimeve Shoqërore.
- Vendosja e sinjalistikës vertikale vetëm në një krah të rrugës pranë Prokurorisë.
- Vendosja e sinjalistikës vertikale të përparësisë në kryqëzimin e Poliklinikës për mjetet që vijnë nga Prokuroria.
- Në rrugët me një sens lëvizjeje, kur e lejon gjerësia, të vendoset sinjalistika vertikale për parkimin në të dyja anët e rrugës.
- Në rrugët me dy sense lëvizjeje, kur lejohet nga gjerësia, të vendoset sinjalistika vertikale për parkim vetëm në një krah.
- Vendosja e sinjalistikës vertikale për moslejin e parkimit në një krah pranë shkollës “24 Maj”.
- Segmenti rrugor “Market Gama – Kryqëzimi PS-së” të kthehet në një sens lëvizjeje dhe të ketë parkim vetëm në një krah të rrugës.
- Rruga “Anita Bitri” të funksjonoj me dy sense lëvizjeje dhe parkim në një krah të rrugës.
- Rruga pas “Supermarket Conadi” të funksjonoj në një sens lëvizjeje.

Konstatime në terren dhe sygjërimet

- Në segmentet Urbane si : Vlorë-Radhime , Ujë i Ftohtë-Jonufër, Skelë-Transballkanike , rruga “ Ali Mihali “ , rruga “ Anita Bitri”, rruga “ Lef Sallata” , “Katriat Gjini”, “Janaq Kilica”, AT “Kristo Negovani”, “Hasan Kushta” paraqesin *ngushtim të karrexhatës, dëmtim të asfaltit në të dy anët e rrugës, fshirje e vijëzimeve horizontale, pengesë për kalimin e këmbësorëve pasi trotualet janë të zaptuara nga materialet e*

ndriçimi. timit gjë e cila sjell kalimin e këmbësoreve në karrexhatë , rrugë që mungon

- Rruga "Gjergj Kastrioti" dëmtime në kufinj të djathtë të karrexhatës, sinjalizim horizontal që përfshinë vëndkalimet e këmbësorëve janë të fshira , sinjalizmet shtesë "Ngadalësueset e Shpejtësisë" në afërsi të vëndkalimeve të këmbësorëve të dëmtuara, mungesë vizibiliteti.
- Rruga "Kosova" ,Segmenti Vola – Skelë me sinjalistikë të pamjaftueshme, asfalt dëmtuar dhe mungesë ndriçimi.
- Rruga "Pelivan Leska" e dëmtuar , me gropa , vëndkalimet e këmbësoreve të padukshme.
- Bulevardi "Ismail Qemali " me shenja të dëmtuara horizontale, mungese në disa pjesë të sinjaleve horizontale.
- Rruga "Dhimitër Konomi" dhe rruga pranë ish Shkollës së Naftës me asfalt të dëmtuar dhe mungesë sinjalizimi vertikal/horizontal.
- Rruga "Sulejman Delvina" nga Gjykata deri të Bishti i Kalldrëmit me gropa , dëmtim të asfaltit , mungesë të sinjalizimeve .
- Segmenti Rrap – Ypsilon mungesë e sinjalizimeve vertikale e horizontale .
- Shkollat 9-Vjeçare e të mesme "Ismail Qemali" , "Ali Demi", "Elitë", "Perla" , "Halim Xhelo", "Jani Minga", "Muço Delo" nevojiten sinjalizime shtesë "Kujdes fëmijë/nxënës" në afërsi të vëndkalimeve të këmbësorëve pranë shkollave.
- Në segmentet autostradë dhe rrugët interurbane kryesore /dytësore problematikat që vihen re kryesisht në rrugët : Vlorë – Llogara , Vlorë -Qeparo , Kuç-Tepelenë , Selenicë -Poçem ku herë pas herë në kushte të reshjeve konstatohen rreshqitje dherash dhe gurësh , mungesë të ndriçimit sidomos në rrethrotullime gjithashtu problematike ka qënë dhe aksi Vlorë -Llogara gjatë sezonit të dimrit ka probleme nga ngricat dhe reshjet e dëborës , mirpo hapja e tynelit ka sjelle përmirësim dhe sigurisë në rrjedhën e qarkullimit .
- Rrethrotullimin "Ish-Vola".
Zgjerim i diametrit të rrethrotullimit.
Rifreskim i sinjalistikës vertikale dhe horizontale.
- Kryqëzimi pranë Universitetit "Ismail Qemali".
Ndërtim i mbikalimit ajror për këmbësorët, ose mbyllje të kryqëzimit .
- Rruga " Gjergj Kastrioti" ndryshe "Transballkanike".
Ngjyrosje e theksuar e vëndkalimeve për këmbësorë
Vendosje e sinjalistikës vertikale paralajmëruese, dhe ngadalësues horizontal në afërsi të vëndkalimeve të këmbësorëve. Asfaltimi i kufinjve të djathtë të korsive në të dy sënset e drejtimit në mënyrë që qytetarët të parkojnë .
- Rruga "Hasan Kushta" ku është projektuar dhe korsia e biçikletave në krahun e djathtë të secilit drejtim sygjerojmë me urgjencë , eliminimin e korsisë së biçikletave pasi për degëzimet hyrëse e dalëse në lagje nuk ka fushëpamje , kjo korsia ka shumë ndërprerje gjë e cila sjell, rrezik të lartë për përdoruesit.
- Duke parë si të arsyeshme dhe emergjente urgjencat mjekësore të cilat lëvizin në sektorin rrugor nga Kapelja deri te Spitali, vërejmë se rruga e spitalit Vlorë, nuk ofron

korsi funksionale emergjencash për autoambulancat pasi korsi ekzistuese nuk ofron një funksion emergjencash për autoambulancat, është anash rrugës dhe shpesh e bllokuar nga parkimi i mjeteve. Në këto kushte autoambulancat hasin vështirësi për të kaluar në oraret e pikut. Parkimi jo i rregullt pengon dhe shkakton vonesa kritike për pacientët. Si zgjidhje, ju sugjerojmë që në këtë aks rrugor mos të ketë parkime mjeteshe në të dyja anët.

- Të hiqet korsi e emergjencës e krahut të djathtë, e cila fillon te Bashkia dhe përfundon në hyrje të Spitalit.
- Të bëhet një korsi emergjence e cila të përbëhet nga sinjalistik horizontale me dy viza të pa ndërprera ngjyrë të verdhë me gjersi nga njëra tjetra 1.9 - 2 m.
- Vendosja e barrierave të ulta me lartësi 20-30cm, fleksibël për të ruajtur korsinë qendrore si dhe të lejojnë vetëm kalimin e autoambulancës.
- Sinjalistika horizontale, vijë e kuqe qendrore,, me dedikimin ose me shënim “Korsi emergjencash” çdo 15 metra si dhe shigjeta orjentuese për devijimin e trafikut.
- Sinjalistik Vertikale të cilat sinjalizojnë “Korsi e dedikuar vetëm për emergjencat” dhe “ndalim parkimi” dhe sinjali “Zhvendosje me karotrec”
- Mjetet e transportit interurban Kombëtar dhe Ndërkombëtar të zhvendosen në segmentin urban kryesor, Rrotondo e Nartës, Rrotondo Kastratit - Rrotondo Nartës, në të dyja krahët e karrexhatave, ku nga ana e Bashkisë është projektuar sot vendqëndrim i mjeteve. Për transportin e udhëtarve të cilët do të lëvizin nga kjo pikë në drejtim të qytetit të vlorës ju sugjerojmë që linjat e miratuara nga ana juaj si Bashki qytetase të zgjaten deri te rrethi i Nartës.
- Linjat ndërqytetase (fshatrave), të zhvendosen paranë ish fabrikës së tullave dhe mos të futen në qytetin e Vlorës.
- Mjetet e transportit të përzier (ATP), ti vihet një fashë orari për furnizim/qarkullim brenda qytet të Vlorës, përvec rrugës Transballkanike, Triport.
- Në rrugën Transballkanike, në segmentin nga rrethrotullimi i Kastratit, ish parku i mallrave që klasifikohet si rrugë urbane kryesore, është një nga rrugët më të ngarkuara në qytetin e Vlorës për qytetar dhe mjete, ka shumë degezime, shume biznese dhe kalime të shpeshta, nga njëra anë e rruges ne tjetren. Këtu shpesh ndodhin aksidente mjet me këmbësor.
- Në të dy krahët e karrexhatës, bazuar në nenin 188 pika 2, të Kodit Rrugorë, vendkalimet e këmbësorve të jenë minimalisht 100 m largë nga njëra tjetra të cilët të funksionojnë me sinjalistikën rrugorë të nevojshme dhe ndricues flesh, ku mes dy rrotondove të ket një semafor inteligjent me buton të përdorshëm nga këmbësorët.
- Shtyllat sinjalistike me panel reflektues që duken natën, ndriçim led, mbikalim i cili rrit dukshmërin e këmbësorit gjatë natës. Ndriçimi të jetë direkt mbi vendkalimin e këmbësorve.
- Kryqëzimi i rrugës Sazani me rrugën e Nartës në Triport si dhe kryqëzimi i Kanalit të motorrit, te pylli i sodës, mendojmë të vihet sinjalistik ndriçuese/flesh semafor inteligjent me buton të përdorshëm nga këmbësorët.
- Kryqëzimi “ura e degës”, mendojmë të vihet sinjalistikë ndriçuese/flesh semafor inteligjent me buton të përdorshëm nga këmbësorët.
- Kryqëzimi i “Mobileri Aliko” mendojmë të vihet sinjalistikë ndriçuese/flesh semafor inteligjent me buton të përdorshëm nga këmbësorët.
- Rrethi i Skelës, mendojmë të vihet sinjalistikë ndriçuese/flesh semafor inteligjent me buton të përdorshëm nga këmbësorët, në të katërta degëzimet.
- Shkolla 9-vjeçare “Ismail Qemali”, të hiqen parkimet nga të dyja krahët.
- Kryqëzimi i Aleksandrisë, të vendoset sinjalistikë përparsie për mjetet që lëvizin në Bulevard.
- Trekëndshi te Sigurimet shoqërore, të rregullohet sinjalistika.

- Prokuroria të bëhet me një krahë parkimi.
Kryqëzimi i Poliklinikës të rregullohet me sinjalistikë përparsie, tu jepet përparësi mjetëve që vin nga Prokuroria.
- Rugët të cilat janë me një sens lëvizje ne qytetin e Vlorës, aty ku e lejonë gjerësia e rruges të vendoset parkim në te dyja krahët.
 - Ne rrugët të cilat janë me dy sense levizje, aty ku e lejon gjerësia e rrugës të vendoset parkimi në një krahë.
 - Rruga te shkolla "24 Maj" të hiqet parkimi në një krahë.
 - Nga "Market Gama" deri te Kryqëzimi PS-së, të bëhet me nje sens levizje dhe nje krahë parkimi.
 - Rruga "Anita Bitri" të bëhet me dy kalime lëvizje dhe me një krahë parkimi.
 - Rruga mbas "Supermarket Conadi" të bëhet me një drejtim lëvizje.

Përfundim

Në përfundim të këtij vlerësimi teknik, rekomandojmë që Bashkia Vlorë të marrë në konsideratë të gjitha sugjerimet e paraqitura, me qëllim vendosjen e një sinjalistike rrugore të standardizuar dhe të pozicionuar në mënyrë strategjike. Zbatimi i këtyre masave do të përbëjë një hap të rëndësishëm drejt krijimit të një infrastrukture më të sigurt, më funksionale dhe të përputhur me standardet bashkëkohore të trafikut urban në qytetin e Vlorës

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin!

DREJTORI

Drejtues Elidon GELA

